



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr.353/3Prot.

Tiranë, më 17/03/2021

**V E N D I M**

**Nr. 48, Datë 17/03/2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 22, datë 23.02.2021, e z. J.B., ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” nga ana e Urgjencës së Spitalit Rajonal Shkodër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se z. J.B. është individ me aftësi të kufizuara<sup>2</sup> dhe është diagnostikuar me epilepsi kronike me turbullime te personalitetit epileptik<sup>3</sup>. Ankuesi sqaron se si pasojë të sëmundjes nga e cila vuan, është i detyruar të kërkojë shpesh ndihmën dhe shërbimin e Urgjencës së Spitalit Rajonal Shkodër.

Për sa më sipër, ai pretendon së Urgjenca e Spitalit Rajonal të Shkodrës nuk i ka dhënë ndihmën e duhur mjekësore, si dhe është ndeshur me sjelljen arrogante të personelit të Urgjencës. Ankuesi pretendon se është nxjerrë me forcë nga roja e Urgjencës, ndërkohë që ka qenë me kriza epileptike. Hera e fundit, që ai është paraqitur pranë Urgjencës së Spitalit Rajonal të Shkodrës është data 18.02.2021, datë në të cilën z. J.B. pretendon se është ankuar tek Drejtori Ekonomik i Spitalit Rajonal Shkodër.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se po diskriminohet nga Urgjenca e Spitalit Rajonal Shkodër, për shkak të aftësisë së tij, të kufizuar.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

<sup>2</sup> Referuar Vendimit nr. 916, datë 02.04.2020, të KMCAP Shkodër.

<sup>3</sup> Referuar aktit “Epikrizë Përcjellëse për Invalidë”, lëshuar në datën 03.09.2020, nga DRSSH Shkodër.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”<sup>4</sup>, i ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, i ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pikat 1 e 2/b, të tij parashikon se: “1. Personi

---

<sup>4</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

*fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi. 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: .....b) mundësi për të marrë ose për të përfitur nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin;”*

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 22, datë 23.02.2021, së z. J.B., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>5</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr.353/1, datë 01.03.2021, Urgjencës së Spitalit Rajonal Shkodër dhe për dijeni ankuesit. Në këtë shkresë kërkohej informacion mbi pretendimet e parashtruara nga ankuesja, si më poshtë vijon:
1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
  2. Numri i rasteve që ankuesi është paraqitur pranë Urgjencës së Spitalit Rajonal të Shkodrës nga muaji korrik 2020, deri në muajin shkurt 2021;
  3. Kopjeve e aktit të pranimit të pacientit në Urgjencën e Spitalit Rajonal të Shkodrës;
  4. Informacion nëse ankuesi ka depozituar ankesë me shkrim pranë Urgjencës së Spitalit Rajonal të Shkodrës;
  5. Nëse po, të dërgohen shkresat përgjigje të këtij institucioni dërguar në adresë të ankuesit;
  6. Çdo informacion tjetër, që ka lidhje me çështjen objekt ankese.
- Në vijim, nëpërmjet një e-maili të dërguar në datën 11.03.2021, në adresë të KMD-së, ankuesi J.B. kërkoj të tërhiqet nga ankesa e tij kundër Urgjencës së Spitalit Rajonal Shkodër.

---

<sup>5</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

Në këto kushte, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”<sup>6</sup>, Komisioneri deklaroi përfundimin e hetimit administrativ të ankesës nr. 22, datë 23.02.2021, së z. J.B., pa një vendim përfundimtar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 5 e 7, pika 1, nenin 20, pikat 1 e 2/b dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 22, datë 23.02.2021, së z. J.B., pasi ankuesi është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha – të mira e shërbime  
Shkak – aftësia e kufizuar  
Lloji i vendimit – pushim/terheqje

---

<sup>6</sup> Neni 94/1, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikon: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”